



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 13.3.2012, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH dhe këshilltari i ministrit Jetmir Bala, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), Behxhet Shala, Tush Markaj dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.3.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbeturina,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.3.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.3.2012.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Mbeturina

Nait Hasani filloi shqyrtimin e projektligjit bashkërisht me të ftuarit duke vazhduar tek neni 18. Diskutimet u zhvilluan rreth amendamenteve të ekspertit Behxhet Shala, sidomos për nenin 14 dhe 15 ku komision krijoi bindjen rreth ekzistimit apo jo të ZRRUM sa i përket menaxhimit me mbeturina, duke konstatuar se projektligji është i arsyeshëm mjaftueshëm sa i përket këtij institucioni, ngase MMPH është ajo që duhet të menaxhoj me mbeturina. Amendamentet janë hartuar në formë tabelare të cilat komisioni edhe një herë do t'i shqyrtoi përfundimisht në një takim të radhës, për të dhënë fjalën përfundimtare rreth këtij projektligji.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 15,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani